



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 korrik 2022
Nr.ref.: RK 2023/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI108/21

Parashtrues

**N.P.Q “Lesna” B.I dhe Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe
Bashkim Deshishku**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA.nr.6119/2019,
të 10 shkurtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga N.P.Q “Lesna” B.I, Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar me autorizim nga Korab R. Sejdiu dhe Burim Azemi nga Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” SH.P.K.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin [CA.nr.6119/2019] e 10 shkurtit 2021 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [PPP.nr.1255/19] e 9 shtatorit 2019 të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimeve të kontestuara, për të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë të jenë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ). Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkeljen e neneve 10 dhe 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Deklarata Universale).
4. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë vendosjen e masës së përkohshme, përmes së cilës do të pezullohej ekzekutimi i Aktvendimit [CA.nr.6119/2019] të 10 shkurtit 2021 të Gjykatës së Apelit.
5. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë që të mbahet një seancë dëgjimore publike lidhur me rastin e tyre.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

7. Më 4 qershor 2021, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 8 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
9. Më 14 korrik 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 18 nëntor 2021, Gjykata kërkoj nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të dorëzojë para Gjykatës dosjen e plotë të rastit.
11. Më 23 nëntor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes shkresës njoftoi Gjykatën se shkresat e lëndës gjenden tek Përmbaruesi Privat, Irfan Kërçagu, në kompetencë për veprime të mëtejshme.
12. Më 26 nëntor 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë “Kërkesë për Urgjencë” lidhur me trajtimin e rastit të tyre.

13. Më 30 nëntor 2021, Gjykata kërkoi nga Përmbartuesi Privat, Irfan Kërçagu që të dorëzojë para Gjykatës dosjen e plotë të rastit.
14. Më 10 dhjetor 2021, Përmbartuesi Privat, Irfan Kërçagu, dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
15. Më 26 maj 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Përmbledhja e fakteve në procedurën kontestimore që ndërlihet me vërtetimin e borxhit

16. Nga shkresat e lëndës, rezulton se Ndërmarrja Prodhuese Qarkulluese “Lesna” si Biznes Individual (në tekstin e mëtejshëm: “Lesna”) është themeluar më 1 qershor 2000, me pronarë Hashim Deshishku, Bekim Deshishku, Riza Deshishku dhe Bashkim Deshishku.
17. Më 16 shkurt 2001, NPQ “Lesna” dhe Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: NPB), kishin lidhur “Kontratën mbi Ndërtimin” me [nr.429/1] (në testin e mëtejshëm: Kontrata), për kryerjen e punëve ndërtimore-zejtare të objektit banesor-afarist “Kroi i Bardhë” në lagjen Dardania, ku në cilësi të investitorit paraqitet NPB ndërsa në anën tjetër si kryerës i punëve paraqitet “Lesna”. Ndër të tjera, në nenin 3 të Kontratës ishte paraparë që të punohet me njësi matëse sipas pozicioneve të përshkruara në projekt të cilat verifikohen nga organet mbikëqyrëse të caktuara nga investitori, respektivisht nga NPB-ja.
18. Më 11 gusht 2003, ishte formuar një Komision i përbashkët i palëve kontraktuese të lartpërmendura, për hartimin e llogarisë përfundimtare, i cili përmes Vendimit [02-1754-1] të tij kishte ardhë në konstatim se cilësia e punës dhe materiali i përdorur nga “Lesna” nuk i përgjete kualitetit të paraparë me projekt.
19. Nga certifikat e regjistrimit të biznesit të “Lesna”, e cila është në shkresa të lëndës dhe njëkohësisht është e qasshme edhe në uebfaqen e ARBK-së, vërehet se “Lesna” kishte qenë e regjistruar si biznes individual me pronarë Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku.
20. Nga shkresat në dosje të lëndës dhe as nga ndonjë parashtrësë e më vonshme nuk mund të konstatohet se ky regjistrim i biznesit individual me katër pronarët të jetë kontestuar nga parashtruesit apo të është kërkuar ndryshimi i statusit juridik të biznesit individual.
21. Më tej rezulton se më 13 gusht 2003, “Lesna” ishte shuar si biznes.
22. Më 17 shkurt 2004, sipas Raportit të situacioneve të NPB-së rezulton se NPB-ja kishte bërë pagesat në vlerë prej 3,152,718.95 euro (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë euro e nëntëdhjetë e pesë cent) në dobi të “Lesna”. Në anën tjetër nga llogaria përfundimtare rezulton se vlera e punëve të kryera nga “Lesna” ishte 2,915,384.95 euro (dy milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë e treqind e tridhjetë e katër mijë euro e nëntëdhjetë e pesë cent).
23. Më 7 qershor 2004, NPB-ja parashtroi padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Ekonomike), kundër “Lesna” duke kërkuar kthimin e mjeteve në vlerë prej 318,315.63 euro (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë mijë euro e gjashtëdhjetë e tre cent) duke pretenduar se vlera e pagesave përmes situacioneve të përkohshme ka tejkaluar vlerën e pagesave, në bazë të llogarisë përfundimtare si dhe duke llogaritur edhe kamatën ligjore nga dita e paraqitjes së kësaj padie deri në pagesën definitive.

24. Në anën tjetër, "Lesna" e përfaqësuar nga K.K përfaqësuesesja së tyre ligjore, paraqiti kundërpadi, në Gjykatën Ekonomike, duke kërkuar që NPB-ja në emër të punëve shtesës t'ia paguajë borxhin asaj në vlerë prej 499.100,82 euro (katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind euro e tetëdhjetë e dy cent).
25. Më 8 prill 2008, Gjykata Ekonomike përmes Aktgjykimit [IV/C.nr.96/2007] vendosi si në vijim: I. Miratoi padinë e NPB-së, në atë mënyrë që e obligoi "Lesna" t'ia kthejë NPB-së shumën në vlerë prej 318,315.63 euro (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë mijë euro e gjashtëdhjetë e tre cent) si dhe shumën prej 49,813.79 euro (dyzet e nëntë mijë e tetëqind e trembëdhjetë mijë euro e shtatëdhjetë e nëntë cent) në emër të tatimit mbi vlerën e shtuar, pra gjithsej shumën në vlerë prej 368.129,53 euro (treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzet e nëntë mijë euro e pesëdhjetë e tre cent) me kamatë përkatëse në lartësi prej 3 %, si dhe detyroi "Lesna" të paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore. II. Refuzoi si të pabazuar kërkespadinë e "Lesna" që të detyrohet NPB-ja t'ia paguajë asaj shumën në vlerë prej 499,100.92 euro (dyzet e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind euro e nëntëdhjetë e dy cent) në emër të punëve shtesë.
26. Në një datë të paspecifikuar, "Lesna" parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Ekonomike, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike me propozim që aktgjykimi i lartpërmendur të priset dhe kundërpadia e tyre të miratohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
27. Më 14 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr.87/2013] refuzoi si të pabazuar ankesën e "Lesna" dhe vërtetoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Ekonomike. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj, ndër të tjera konsideroi se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, dhe se aktgjykimi i ankimuar është mjaftueshëm i arsyetuar.
28. Në një datë të paspecifikuar, "Lesna" paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike me propozim që aktgjykimi i lartpërmendur të priset dhe kundërpadia e tyre të miratohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.
29. Më 12 korrik 2017, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.19/2017] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruar nga "Lesna" ndërsa Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Apelit e vërtetoi. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e lartpërmendur konstatoi se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale. Për më tepër, Gjykata Supreme theksoi se: *"Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe jo i përfshirë me kundërthënie dhe në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante dhe të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike, andaj konsiderohet se pretendimet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, aktgjykimet e instancës më të ulët nuk mund të vihen në pikëpyetje"*.

Përmbledhja e fakteve në procedurën përmbarrimore

30. Më 10 mars 2016, NPB-ja paraqiti propozim për Përmbarrim tek Përmbarruesi Privat, Vais Law-Prishtinë, në bazë të titullit përmbarrimor, përkatësisht Aktgjykimit [IV.C.nr.96/2007] të Gjykatës Ekonomike me propozim si në vijim: i) të konfiskohen llogaritë bankare të "Lesna" dhe të barten mjetet financiare nga konto e biznesit në konton e veçantë bankare të Zyrës

Përmbarimore “Vais Law”; ii) nëse “Lesna” nuk ka mjete të mjaftueshme, atëherë Përmbaruesi Privat të sekuestrojë, vlerësojë dhe të shesë sendet e luajtshme apo pronat e paluajtshme që gjenden në pronësi të “Lesna”; si dhe iii) nëse përmbarimi është i pamundur ndaj “Lesna”, duke marrë për bazë se biznesi është individual, dhe në bazë të Ligjit për Shoqëri Tregtare, përgjegjësia e pronarëve është e pandarë ndaj përgjegjësisë së biznesit individual, propozimi të shtrihet ndaj pasurive personale të pronarëve të biznesit.

31. Më 12 mars 2016, Përmbaruesi Privat, Vais Law, përmes Urdhrit Përmbarimor [P.nr.275/16], lejoi përmbarimin e propozuar nga NPB-ja.
32. Më 29 mars 2016, “Lesna” paraqiti prapësim në Gjykatën Themelore, kundër Urdhrit Përmbarimor [P.nr.275/16] duke pretenduar se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat e parapara me Ligjin Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejshëm: LPP), respektivisht nenin 71 pikat 1.1 dhe 1.2, duke pretenduar se urdhri përmbarimor, nuk ka tiparet e përmbarueshmërisë, sepse i njëjti ka humbur efektin duke marrë parasysh se “Lesna” është shuar si biznes në vitin 2003. Për më tepër, në prapësim “Lesna” thekson se është pa asnjë bazë ligjore të kërkohej nga pronarët e biznesit të përmbushin obligimet përmbarimore, pasi që të njëjtit nuk kanë qenë subjekt gjykimi në procedurën kontestimore ku ishte vërtetuar borxhi.
33. Më 4 prill 2016, NPB kishte parashtruar në Gjykatën Themelore përgjigje në prapësim, duke i konsideruar të gjitha pretendimet e debitorit si të paqëndrueshme.
34. Më 12 janar 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit [PPP.nr.297/2016] refuzoi si të pabazuar prapësimin e “Lesna”.
35. Në Aktvendimin e saj Gjykata Themelore konstatoi se: *“Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.C.nr.96/2007 i datë 08.04.2007, i plotfuqishëm nga 25.02.2016 dhe i ekzekutueshëm nga 07.03.2016 si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.87/2013 i datë 14.12.2015 në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, i cili dokument përmbarues përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22, 24 dhe 27 i LPP-së, për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim”*. Më tutje, në Aktgjykimin e lartpërmendur Gjykata Themelore theksoi se “Lesna” nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tyre ashtu siç parashihet me dispozitat e LPP.
36. Më 26 janar 2017, parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar vendosjen e masës së përkohshme kundër Aktvendimit [PPP.nr.297/2016] të 12 janarit 2017 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se kjo e fundit duke vendosur lidhur me prapësimin nuk i kishte vlerësuar pretendimet e parashtruara në prapësim duke përfshirë edhe pretendimin se në dispozitiv të Aktgjykimit [IV.C.nr.96/2007] të 8 prillit 2007 të Gjykatës Ekonomike nuk janë të cekur emrat e pronarëve të “Lesna”, dhe sipas tyre ishte tejkaluar kompetenca e përmbarimit.
37. Më 27 janar 2017, parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe duke shtuar se me zbatim të përmbarimit debitorit do t'i shkaktohen dëme të pariparueshme. Më tutje, pretenduan se Urdhri Përmbarimor [P.nr.174/16] është në kundërshtim me dispozitat e parapara me LPP, respektivisht nenin 71 pika 1.1 dhe paragrafi 71.1.2, duke pretenduar se urdhri përmbarimor, nuk ka tiparet të përmbarueshmërisë, sepse i njëjti ka humbur efektin duke marrë parasysh se “Lesna” është shuar si biznes në vitin 2003 si dhe pretendimin se Gjykata Themelore duke vendosur lidhur me prapësimin nuk kishte marrë parasysh faktin se në dispozitiv të Aktgjykimit [IV.C.nr.96/2007] nuk janë të cekur emrat e pronarëve të “Lesna”, dhe sipas tyre ishte tejkaluar kompetenca e përmbarimit.

38. Më 24 shkurt 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr.489/2017] e refuzoi si të pathemeltë ankesën e “Lesna” dhe e vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr.297/2016] e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit konsideroi se “Lesna” nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tyre ashtu siç parashihet me nenin 61 paragrafi 4 të LPP-së.
39. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 3 mars 2017, Zyra e Përmbarimit Vais Law kishte kërkuar nga Gjykata Supreme, dhënien e mendimit juridik lidhur me rastin konkret, ku pas elaborimit të rastit kishte kërkuar që Gjykata Supërme të përgjigjet në pyetjet si në vijim: i) që nëse gjatë ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike, procedura përmbarimore të zhvillohet vetëm ndaj subjektit të cekur në Aktgjykim, duke qenë se në rastin konkret NPB-ja nuk ka kërkuar që përgjegjësia të shtrihet edhe ndaj pronarëve të “Lesna”.
40. Më 17 mars 2017, “Lesna” kishte paraqitur ankesë ndaj Përmbaruesit Privat Vais Law, tek Organi Përmabruës, Oda e Përmbaruesve Privatë, dhe Ministria e Drejtësisë duke pretenduar se: *“Përmbaruesi Privat duke mos respektuar ligjet në fuqi dhe duke ndryshuar dispozitivin e Aktgjykimit, dokumentit përmbarues Aktgjykimi IV.C.nr.96/2007, ka quar deri tek dhënia e urdhërit. Nga ky ndryshim i dispozitivit në urdhrin përmbarimor në kuptimin subjektiv të palëve i’a ka humbur kuptimin gramatikor duke futur në urdhër përmbarimor personave dhe numra biznesesh të cilët fare nuk kanë qenë objet gjykimi gjatë procedurave gjyqësore”*.
41. Më 5 mars 2017, Oda e Përmbaruesve Privatë, përmes përgjigjes në ankesë theksoi se *“nuk ekziston asnjë dyshim i bazuar për iniciimin e procedurës disiplinore kundër përmbaruesit privat, për rastin konkret”*.
42. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit parashtruan propozim për iniciimin e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
43. Më 27 mars 2017, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në Gjykatën Supreme paraqiti Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë [KMLC.nr.28/2017] kundër Aktvendimit [PPP.nr.297/2016] të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Aktvendimit [CA.nr.489/2017] të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore. Specifikisht në kërkesësën për mbrojtje të ligjshmërisë, specifikohet se:
- i) “Lesna” përveç prapësimit kishte paraqitur edhe kërkesë për masë të përkohshme të sigurisë mirëpo gjykata ende nuk ka vendosur për këtë të fundit, dhe sipas Zyrës së Kryeprokurorit kontesti është edhe më tutje në vazhdim;
 - ii) Propozimi për përmbarim nuk përputhet me titullin përmbarues, sepse në aktgjykim i cili do të ekzekutohet nuk përmenden fare pronarët e “Lesna; dhe
 - iii) Njoftoi Gjykatën Supreme se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit më 7 mars 2017, kishte paraqitur edhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit xxxxxxxxxxxx ku kishte pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore sepse *“gjykata e shkallës së parë nuk i ka dorëzuar të paditurës-kundërpaditëses N.P.Q “Lesna” aktgjykimin e saj [...] por këtë aktgjykim ja ka dorëzuar personit të paautorizuar”*.
44. Më 13 qershor 2017, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktvendimit [CML.nr.2/2017] Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë e refuzoi si të pabazuar. Më tutje Gjykata Supreme përmes këtij Aktvendimi theksoi:
- “Është i pa bazuar, madje edhe i pa kuptueshëm dhe kundërthënës pretendimi i theksuar në kërkesë për mbrojtje të Ligjshmërisë, se aktvendimet e goditura përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 247.1 pika të LPK, nga se*

sipas kësaj kërkesë është vendosur për kërkesën rreth se cilës kontestimi është në vazhdim, me që asnjëra nga këto gjykata nuk kanë vendosur për propozimin e debitorit për masën e propozuar të sigurisë. Qëndron fakti se në këtë dispozitë ligjore si shkak për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është edhe nëse është vendosur për kërkesën rreth se cilës kontestimi është në vazhdim, mirëpo, kjo dispozitë ligjore ka të bëjë me çështjen që është vendosur më parë apo që procedura është në vazhdim, dhe tani vendoset në një kontest tjetër rreth çështjes së njëjtte. Gjykata Supreme gjen se në rastin konkret, me që nuk është vendosur edhe lidhur me masën e propozuar të sigurimit, nuk kemi të bëjmë as me çështje të gjykuar /neni 166 të LPK/, e as me gjyq varësi /neni 262 i LPK/. Gjyq varësi /litispendence/do të kishim atëherë kur gjate procesit kontestimor i cili fillon kur te paditurit i dorëzohet padia, për të njëjtën kërkesëpadi inicohet gjykim i ri midis palëve të njëjtte. Ndërsa për tu konsideruar një çështje e gjykuar, duhet të plotësohen katër kushte: identiteti i palëve procedurale, identiteti i kërkesëpadisë, identiteti i gjendjes faktike dhe kontesti të jete filluar, zhvilluar dhe përfunduar në procedure kontestimore. Në rastin konkret nuk i kemi asnjërën prej këtyre instituteve juridike.

[...]

U refuzuan si ta pa bazuara edhe pretendimet tjera të Prokurorit të Shtetit se urdhëri për lejimin e përmbarimit është konfuz nga se na aktgjykimin e plotfuqishë përmbarimi i të cilit është lejuar përmendet vetëm debitori Ndërmarrja Prodhuese Qarkulluese "Lesna" Zona Industriale në Fushë Kosovë, e jo edhe pronaret Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku, të gjithë nga Prishtina, kjo nga se përmendja e emrave të pronarëve në aktvendimin për lejimin e përmbarimit është irelevante sepse titulli përmbarimor i referohet detyrimit të debitorit NPQ "Lesna" lidhur me borxhin. Ndërkaq, nga titulli përmbarimor nuk rezulton se pronaret duhet të paguajnë këta borxh. Prandaj, pretendimet e Prokurorit të Shtetit për këtë kinse kundërtënie, nuk janë me ndikim në drejtshmërinë, ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktvendimeve të goditura me kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

[...]

Gjykata Supreme vlerësoi edhe pretendimet tjera të Prokurorit të Shtetit se kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë IV.C.nr.96/2007 datë 11.10.2016, dhe kundër aktvendimit të Gjykatës Apelit Ac.nr. 231/2016 datë 14.12.2016 është paraqitur revizion dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se qëndron ky fakt, mirëpo nga shiqimi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme E.Rev.MLC.nr.5/2017 datë 22.03.2017 rezulton se këto aktvendime kanë të bëjnë me kthimin në gjendjen e mëparshme, dorëzimin me rregull të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin është vërtetuar titulli përmbarimor".

45. Më 24 gusht 2017, Zyra Përmbarimore Vais Law, përmes Urdhrit [P.nr.174/16], konsideroi se "Përmbarimi në rastin konkret konsiderohet i përfunduar duke qenë se është bërë i pamundur dhe nuk mund të zbatohet". Më tutje në arsyetim shtohet se biznesi "Lesna" "rezulton se është shuar dhe se nga Aktvendimi i Gjykatës Supreme përmbarimi ndaj pronarëve të biznesit është pamundësuar, organi përmbarues në përputhje me nenin 66.3 vendos t'a përfundoj procedurën përmbarimore".
46. Më 25 gusht 2017, NPB-ja i ishte drejtuar Kryetares së Odës së Përmbaruesve Privatë dhe Ministrisë së Drejtësisë me kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat, Valdrin Beka nga Shqëria e Përmbaruesve Vais Law, për moszbatim të Urdhrit përmbarimor [P.nr.174/16] të 11 marsit 2016.
47. Më 14 nëntor 2017, Ministria e Drejtësisë-Komisioni Disiplinor për Përmbaruesit Privatë, përmes Vendimit [Nr.09/2017] vendosi se Përmbaruesi Privat, Valdrin Beka është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 341 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nga neni 367 të LPP-së, dhe në këtë mënyrë i shqipton masën disiplinore "Vërejtje".

48. Më 19 dhjetor 2017, Zyra Përmbarimore Vais Law, përmes Konkluzionit korrigjues, theksoi se korrigjohet/plotësohet Urdhri [P.nr.174/16] me të cilin procedura përmbarimore konsiderohet e mbyllur, me Këshillën Juridike në bazë të së cilës lejohet ankesa.
49. Më 26 dhjetor 2017, NPB-ja kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Themelore, për shkak të parregullsive të kryera nga organi përmbarues gjatë procedurës së përmbarimit.
50. Më 26 prill 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PPP.nr.297/16] vendosi si në vijim: I. aprovoi si të bazuar ankesën e NPB-së; II. Anuloi Urdhrin P.nr.174/16, dhe vendosi që lënda t'i kthehet Zyrës Përmbarimore Vais Law ta realizojë përmbarimin sipas propozimit të NPB-së, në cilësi të kreditorit. Në Aktvendimin e lartpërmendur ndër të tjera shtohet:

“Gjykata vlerëson se në këtë fazë të procedurës, në procedurë përmbarimore në bazë të nenit 48.1 dhe 2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, pasuria e pronarit të Biznesit Individual konsiderohet edhe pasuri e Biznesit Individual që është palë debitore. Pra në Procedurën Përmbarimore nuk është relevante se a është përshirë pronari i Biznesit Individual si debitor në titullin përmbarimor apo jo. ngase pasuria është unike e pandarë dhe e tëra është objekt i ekzekutimit sipas rregullave të Ligjit të Procedurës Përmbarimor. Në rastin konkret pasuria e pronarit konsiderohet edhe pasuri e Biznesit Individual dhe pasuria e Biznesit Individual, konsiderohet pasuri e pronarit. Në rastin konkret nuk janë plotësuar tri kushtet nga neni 48.3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. për përjashtimin e pasurisë së pronarit të Biznesit Individual, pasi që as titulli ekzekutiv, Aktgjykimi IV C.nr.96/2007 të datës 08.04.2007. i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë i plotfuqishëm nga data 25.02.2016 dhe i ekzekutueshëm nga data 07.03.2016, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.87/2013. i datës 14.12.2015 as propozimi i kreditorit e as Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës CML.nr.2/2017 nuk i kane përjashtuar asetet e pronareve të Biznesit Individual.”

51. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku, parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore duke kërkuar që ky i fundit të anulohet dhe të mbetet në fuqi Urdhri [P.nr.174/16] me të cilin ishte përfunduar procedura përmbarimore. Bekim Deshishku gjithashtu propozoi që të vendoset masa e sigurisë kundër Aktvendimit [PPP.nr.297/2016] të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
52. Më 17 shtator 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.2624/2018] aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe çështjen e ktheu në rigjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke vlerësuar se kjo e fundit gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale dhe si pasojë gabimisht është konstatuar gjendja faktike. Gjykata e Apelit, në vijim refuzoi si të pabazuar propozimin e Bekim Deshishkut për caktimin e masës së sigurisë kundër Aktvendimit [PPP.nr.297/2016] të Gjykatës Themelore.
53. Në një datë të paspecifikuar, Zyra e Përmbarimit Vais Law, përmes tri Konkluzioneve të lëshuara obligoi Zyrën Kadastrale në Prishtinë, Zyrën Kadastrale në Ferizaj dhe Zyrën Kadastrale në Podujevë që të bëjnë heqjen e shënimeve të përmbarimit në librat publik të disa paluajtshmërive të evidentuara në emër të Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku, me të cilat kishte kërkuar që përmbarimi të realizohet përmes shitjes së po këtyre paluajtshmërive të cilat janë në emër të tyre. Ndër të tjera në arsyetim të këtyre Konkluzioneve përmendet edhe Aktvendimi [Ac.nr.2624/2018] i Gjykatës së Apelit përmes së cilit ishin pranuar si të bazuara ankesat e Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku dhe çështja ishte kthyer në rigjykim.
54. Më 16 shkurt 2018, Zyra e Përmbarimit Vais Law, i ishte drejtuar Gjykatës Themelore me kërkesë për përjashtim nga procedura e përmbarimit të lëndës [PPR.174/2016], duke theksuar se: *“duke parë tendencën dhe mosbesimin e Kreditorit në vazhdimësi në raport me punën e*

organit përmbarues, me pretendimet se zyrja jonë ka bërë shkelje procedurale në këtë lëndë konsiderojmë se është e domosdoshme që bazuar në nenin 67 pika (g) të LPK-së të përjashtohemi nga ky rast përmbarimor”.

55. Më 8 janar 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr.1256/18] aprovoi kërkesën e Zyrës Përmbarimore Vais Law për përjashtim nga kjo lëndë dhe vendosi që lidhur me këtë lëndë të caktohet një përmbarues privat tjetër.

Procedura e parë e rigjykimit në Gjykatën Themelore

56. Më 8 shkurt 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar në rigjykim, përmes Atvendimit [PPP.nr.1256/18] aprovoi si të bazuar ankesën e NPB-së, për eliminimin e parregullsive të kryera nga organi përmbarues gjatë procedurës përmbarimore, dhe anuloi Urdhrin [P.nr.174/16], duke e kthyer lëndën tek Përmbaruesi Privat për përmbarim sipas propozimit të NPB-së, në cilësi të kreditorit.
57. Më 25 shkurt 2019, parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Themelore prashtruan propozim për caktimin e masës së përkohshme kundër Aktvendimit [PPP.nr.1256/18] të 8 shkurtit 2019, të Gjykatës Themelore.
58. Në një datë të paspecifikuar, Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bashkim Deshishku dhe Bekim Deshishku paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar konstatim të gabuar të gjendjes faktike, dhe duke kërkuar që kjo çështje të konsiderohet e përfunduar në bazë të Urdhrit [P.nr.174/16], apo të kthehet në Gjykatën Themelore për rishqyrtim.
59. Më 8 prill 2019, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PPP.nr.1256/18] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme kundër Aktvendimit [PPP.nr.1256/18] të 8 shkurtit 2019, të Gjykatës Themelore.
60. Më 29 prill 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [A.C.nr.1474/19] aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe çështjen e ktheu në rigjykim në Gjykatën Themelore, duke vlerësuar se kjo e fundit gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale dhe si pasojë gabimisht është konstatuar gjendja faktike.

Procedura e dytë e rigjykimit e cila në mënyrë shprehimore kontestohet para Gjykatës

61. Më 9 shtator 2019, Gjykata Themelore duke vepruar në rigjykim përmes Aktvendimit [PPP.nr.1255/19] aprovoi si të bazuar ankesën e NPB-së, për eliminimin e parregullsive të kryera nga organi përmbarues gjatë procedurës përmbarimore, dhe anuloi Urdhrin [P.nr.174/16], duke e kthyer lëndën tek Përmbaruesi Privat për përmbarim sipas propozimit të NPB-së, në cilësi të kreditorit.
62. Në një datë të paspecifikuar, Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bashkim Deshishku dhe Bekim Deshishku në Gjykatën e Apelit paraqitën ankesë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore duke pretenduar konstatim të gabuar të gjendjes faktike, dhe duke kërkuar që kjo çështje të konsiderohet e përfunduar në bazë të Urdhrit [P.nr.174/16], apo të kthehet në Gjykatën Themelore për rishqyrtim.
63. Më 10 shkurt 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr.6119/2019] refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruara nga Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bashkim Deshishku dhe Bekim Deshishku, dhe vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr.1255/19] të 9 shtatorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

64. Në fund, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktvendimit të lartpërmendur, ku ndër të tjera shtohet se:

Gjykata e Apelit konstaton se me dispozitën e nenit 5 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së UNMIK 2001/16, në të cilën thirret ankuesi, është paraparë përgjegjësia e pronarit të ndërmarrjes punuese private, është paraparë citim: "Në çdo procedurë gjyqësore, arbitrazhi, falimentimi apo procedure permbarimore pas aktgjykimit, asnjë gjykatë apo organi i arbitrazhit nuk ka të drejtë të tentoj të ndajë pasurinë e pronarit të biznesit individual në pasuri që ai e përdor me qëllim ushtrimin e veprimtarisë tregtare dhe në pasuri të cilën pronari e përdor për qëllime personale, të shtëpisë, apo familjes, përveç në rastin se ashtu është paraparë me marrëveshje e cila është bazë e kërkesës, që bartësi i kërkesës se tillë pajtohet me atë, ose që ligji për permbarimin e aktgjykimit ose për falimentim parashikon përjashtimin e pronës së tillë.

Më tej, me dispozitën e nenit 48 par 1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr.06/L-016 i cili ka hy në fuqi me datën 24.05.2018, në të cilën thirret ankuesi, është parapare përgjegjësia e pakufizuar e pronarit të ndërmarrjes individuale [...]Në ankesë është cekur se citi "Biznesi individual nuk mund të ketë më tepër se një pronarë" duke u thirr në Ligjin Nr.06/L-016 për Ndermarrjet Tregtare, megjithatë sipas qëndrimit të Gjykatës së Apelit, nuk është interpretuar ligji i përmendur, për atë se me shikimin në të njëjtin dhe atë në nenin 48 par 1 është konstatuar, citim"Një person mund të ketë vetëm një biznes individual.

Atëherë, me dispozitën e nenit 48 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr.02/L-123 i cili ka hy në fuqi me datën 01.10.2008, është parapare gjithashtu përgjegjësia e pakufizuar

[...]"

65. Më 6 prill 2021, parashtruesit e kërkesës i parashtruan Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, propozimin për iniciimin e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, kundër Aktvendimit [CA.nr.6119/2019] të 10 shkurtit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimit [PPP.nr.1255/19] të 9 shtatorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
66. Më 15 prill 2021, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit [KMLC.nr.31/2021] refuzoi propozimin e parashtruesve të kërkesës për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë duke konsideruar se pretendimet e parashtruesve të kërkesës nuk janë të mjaftueshme për të ngritur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.
67. Më 29 qershor 2021, Përmbauesi Privat Irfan I. Kërçagu, përmes Konkluzionit [nr.785/21] pranoi lëndën përmbaimore [P.nr.174/16], të dorëzuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe njoftoi se procedura përmbaimore në këtë rast tani e tutje do të udhëhiqet nga Përmbauesi Privat Irfan I. Kërçagu.
68. Më 19 korrik 2021, Përmbauesi Privat, Irfan I. Kërçagu, përmes Konkluzionit [P.nr.523/21] caktoi SH.B. si ekspert financiar në këtë rast lidhur me përllogaritjen e kamatës vjetore në lartësi prej 3 % duke filluar nga 7 qershori 2004 e deri në pagesën definitive të borxhit.
69. Më 21 korrik 2021, eksperti financiar Sh.B. dorëzoi tek Përmbauesi Privat, Irfan I. Kërçagu, ekspertizën financiare.
70. Më 21 korrik 2021, Përmbauesi Privat, Irfan I. Kërçagu, përmes Urdhrit Përmbaimore me numër [P.nr.523/2021] urdhëroi që të gjitha bankat e licencuara nga Banka Qendrore në Kosovë të bllokojnë llogaritë bankare të Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

71. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Aktvendimet e kontestuara, përkatësisht Aktvendimi [CA.nr.6119/2019] i 10 shkurtit 2021 i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [PPP.nr.1255/19] e 9 shtatorit 2019 të Gjykatës Themelore, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) si dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkeljen e neneve 10 dhe 17 të Deklaratës Universale.
72. Parashtruesit e kërkesës në thelb kontestojnë Aktvendimet e lartcekura duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke pretenduar se janë cenuar dy komponentë të nenit 31 të Kushtetutës, respektivisht në rastin e tyre: (i) ka zbatim të gabuar të dispozitave ligjore; dhe (ii) cenim të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit.
73. Parashtruesit e kërkesës fillimisht pretendojnë se "Lesna" ka qenë e shuar si Biznes që nga viti 2003, dhe sipas tyre procedura kontestimore dhe ajo përmbarimore janë zhvilluar kundër një biznesi i cili nuk ka qenë ekzistent. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës shtojnë se Biznesi Individual siç ka qenë "Lesna" nuk mund të ketë më shumë se një pronar, dhe se përgjegjës për borxhet nuk mund të jenë personat që asnjëherë nuk kanë qenë pronarë të subjektit të shuar.

Lidhur me pretendimin për zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore

74. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata e Apelit përmes Vendimit të kontestuar ka zbatuar gabimisht nenin 5 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 për Shoqëritë Tregtare, ku si pasojë është cenuar neni 46 i Kushtetutës.
75. Më tej parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata e Apelit këtë dispozitë ligjore është dashur ta interpretojë në kontekst të nenit 5.1, i cili sipas tyre ndër të tjera thekson se vetëm personi fizik mund të jetë pronar i biznesit individual e jo personat fizikë, sikur në rastin konkret.
76. Në ndërlidhje me këtë parashtruesit e kërkesës theksojnë se "Rregullorja në fjalë thekson se vetëm personi fizik mund të jetë pronar i biznesit individual e jo personat fizik pra në shumë. Këtë interpretim e mbështet edhe neni 8.1 i Rregullores 2001/6 [...] Pra elementi kryesor dallues në mes të Biznesit Individual dhe Shoqërisë Kolektive është se Biznesin Individual mund të themelojë vetëm një person fizik që tregon edhe vet emrin e tij, për dallim prej Shoqërisë Kolektive e cila mund të themelohet nga dy a më shumë persona". Sipas parashtruesve të kërkesës dallimi i lartpërmendur është me shumë relevancë sepse sipas tyre "Lesna" ka qenë biznes individual ndërsa në anën tjetër si debitor paraqiten më shumë persona, që sipas tyre kjo bie ndesh me paragrafin 1 të nenit 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6.
77. Parashtruesit e kërkesës tutje shtojnë se: "Gjykata e Apelit ka konstatuar se Biznesi Individual NPQ "Lesna" është i shuar. Rregullorja e UNMIK-ut e po ashtu edhe Ligji për Shoqëritë Tregtare me asnjë dispozitë të vetme nuk flasin për borxhet e "biznesit individual" pas shuarjes së tij. Interpretimi i dispozitave ligjore nuk guxon të tejkalon përmasat e asaj çka parashihet me ligj".
78. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se Gjykata e Apelit ka zbatuar gabimisht nenet 53 dhe 54 të Ligjit për Ndërrmarjet, sepse sipas tyre asnjëra nga elementet e kësaj dispozite nuk plotësohet në rastin konkret dhe për më tepër aplikimi i kësaj dispozite përjashtohet sepse sipas tyre: "bazuar në nenin 41 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 parashihet që "Kjo

rregullore shfuqizon të gjitha dispozitat e ligjit të zbatueshëm të cilat janë në kundërshtim me të”.

79. Parashtruesit e kërkesës në fund shtojnë se: *“Gjykata Supreme në lidhje me këtë çështje juridike në Aktvendimin e saj CML.2/2017 ka mbajtur qëndrimin juridik se “çështja e debitorëve në cilësi të personave fizik as që mund të diskutohet sepse titulli përmbarimor i referohet vetëm NPQ “Lesna”. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se Gjykata e Apelit bie ndesh me qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme”.*

Lidhur me pretendimin për shklejen e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit

80. Në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për cenim të parimit të barazisë së armëve dhe atij të kontradiktoritetit, këta të fundit fillimisht potencojnë faktin se në procedurën kontestimore të zhvilluar lidhur me këtë rast, në të cilën është vërtetuar borxhi, si palë ndërgjyqjese kanë qenë NPB-ja dhe “Lesna” ndërsa Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku nuk kanë marrë pjesë në procedurën gjyqësore dhe në këtë mënyrë *“nuk kanë pasur mundësi të paraqesin përgjigjet, provat dhe argumentet e tyre në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre”.*
81. Në mbështetje të këtij pretendimi parashtruesit e kërkesës i referohen disa rasteve të Gjykatës, respektivisht rasteve: KI200/13, parashtrues *Belkize Kallaq*; KI108/10, Parashtrues *Fadil Selmanaj*; dhe KI209/19 parashtrues *Memli Krasniqi*.
82. Duke u thirrur në rastet e lartpërmendura të Gjykatës, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Palët në procedurë, përveç që duhet të jenë të evidentuara si palë në parashtruesat e dorëzuara në Gjykatë, të njëjtave duhet që pashmangshmërisht të iu ofrohet mundësia e paraqitjes së përgjigjeve, argumenteve dhe provave të tyre”.* Parashtruesit e kërkesës theksojnë se atyre nuk i'u është dhënë mundësia të jenë palë dhe të paraqesin argumentet e tyre gjatë procedurës kontestimore.

Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës]

83. Në ndërlidhje me këtë pretendim parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Në procedurën e përmbarimit, zotërinjëve, Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku , u është cenuar prona në mënyrë arbitrare, fillimisht nga ana e Përmbaruesit Privat, e më pas edhe nga ana e gjykatave të rregullta të vendit tonë, të cilët ishin të vetëdijshëm se Parashtruesit nuk ishin të evidentuar në dokumentin përmbarimor, kishin lejuar përmbarimin edhe në pjesët e pasurisë private të tyre, duke i caktuar si Debitor”.*
84. Në mbështetje të këtij pretendimi parashtruesit e kërkesës u janë referuar disa rasteve të Gjykatës, si në vijim: KI76/10, KI82/10, KI83/10, KI102/10, KI111/10, KI122/10, KI127/10, KI11/11, KI15/11, KI18/11, KI45/11, KI47/11, KI48/11, KI50/11, KI57/11, KI60/11, KI69/11, KI71/11, KI75/11 dhe KI79/11, me parashtrues *Ilaz Halili dhe 20 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës*, si dhe rasteve KI83/11, KI128/12, KI100/12 dhe KI49/13, me parashtrues *Isa Grajqevci, Fehmi Ajvazi, Musli Nuhiu dhe Ramadan Imeri*.

Lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme

85. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“Ky është rast tipik i rrethanave kur masa e përkohshme është e domosdoshme”.*
86. Në ndërlidhje me këtë parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Cenimi arbitrar i pasurisë se Parashtruesve (Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku), krijon një precedent te*

rrezikshëm dhe cenon rëndë sigurinë juridike të subjekteve të së drejtës sepse procedura gjyqësore pranë gjykatave të rregullta ka instaluar përgjegjësi për të tjerët në kundërshtim me çdo dispozitë ligjore në fuqi. Kjo për faktin se, procedura përmbartimore është iniciuar dhe përfunduar edhe ndaj Parashtruesve (Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku) me anë të një dokumenti përmbartimor, i cili është nxjerr në procedurën kontestimore, procedurë e cila shërben si procedurë e faktit (siç është sqaruar në Kërkese, pa pjesëmarrjen si palë të Parashtruesve), i cili ka shërbyer si bazë për të marrë pasurinë e (Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku), në procedurë të përmbartimit apo siç njihet në procedurën e ekzekutimit. Rrjedhimisht, rezultati i arritur në procedurë të faktit nuk ka pasur as për se afërmi qëllimin i cili është realizuar në procedurë të ekzekutimit.

Kjo masë e përkohshme është tejte e nevojshme sepse çdo pamundësi e kthimit të shumës së marrë në mënyrë të kundërligjshme nga ana e Ndërmarrjes Publike Banesore, do të zvarriste këtë procedurë të padrejtë, me ç'rast Parashtruesve edhe me tutje do t'iu pamundësohej shfrytëzimi i pasurisë së tyre, pasuri kjo e krijuar në mënyrë të ligjshme por e cenuar në mënyrë arbitrare nga sistemi i drejtësisë kosovare”.

Lidhur me kërkesën e parashtruesve për mbajtjen e një seance dëgjimore lidhur me rastin e tyre

87. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë: “që për shkak të natyrës së komplikuar procedurale të rastit dhe me qëllim që ta kuptojmë tërësisht thelbin e çështjes të caktoj mbajtjen e seancës dëgjimore”.
88. Krejt në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata si në vijim:

“I. **TE DEKLAROJE** kërkesën të pranueshme;

II. Duke pasur parasysh shkeljet serioze të të drejtave kushtetuese' gjatë procedurave gjyqësore dhe dëmit të pariparueshëm që do të shkaktonte pamundësia e kthimit të mjeteve të marra pa bazë ligjore, të lëshojë vendim për mase të përkohshme në Përputhje me Nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Neneve 54 dhe 55 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me ç'rast pezullon ekzekutimin e aktgjyqimit të shkalles së parë deri në shpalljen e aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast;

III. Në përputhje me Rregullin 39 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, **TE URDHEROJ** mbajtjen e seancës dëgjimore;

IV. **TE KONSTATOJE** se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës CA.nr.611912019, date 10.02.2021. ka shkelje të Nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Nenit 10 dhe 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe të Nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve të saj, dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

V. **TE DEKLAROJE** të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.611912019, të datës 10.02.2021;

VI. **TE KTHEJE** rastin në Gjykatën e Apelit për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;

VII. Të përcaktojë çfarëdo mase tjetër juridike që kjo Gjykate e nderuar e vlerëson si të bazuar juridikisht dhe të arsyeshme.”

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

Prokollli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1 (Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/6 për Shoqëritë Tregtare

Neni 5 Përgjegjësia e Pronarit

5.1 Personi fizik që kryen veprimtari tregtare, jo si përfaqësues apo si nëpunës i një shoqërie tregtare, vepron si biznes individual. Personi fizik që kryen veprimtari si një biznes individual mban përgjegjësi për të gjitha borxhet e krijuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij me gjithë pasurinë e tij.

5.2 Në asnjë procedurë gjyqësore, arbitrazhi, falimentimi apo ekzekutimi vendimi, gjykata apo organi i arbitrazhit nuk mund të ndajë pasurinë e pronarit të biznesit individual në pasuri që ai e përdor me qëllim ushtrimin e veprimtarisë tregtare dhe në pasuri të cilën pronari e përdor për qëllime personale, të shtëpisë, apo familjes, përveç rasteve kur marrëveshja në të cilën bazohet ngritja e padisë përkatëse e parashikon një gjë të tillë, ose kur paditësi bie dakord më vonë me këtë, ose kur rregullorja apo ligji për ekzekutimin e vendimeve apo falimentimit parashikon përjashtimin e një pjese të caktuar të pasurisë.

LIGJI Nr. 02/L -123 PËR SHOQËRITË TREGTARE [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 1 tetor 2008]

NDËRMARRJA INDIVIDUALE

Neni 48

Përgjegjësia e Pakufizuar, nuk është Person Juridik

48.1 Personi i cili është pronar i një ndërmarrje individuale, qoftë të regjistruar apo të pa regjistruar, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një ndërmarrje individuale. Kjo përgjegjësi është e pa-kufizuar dhe përfshin tërë pronën dhe asetet e cfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të këtij personi, pavarësisht nga fakti se nëse prona/asetet e tilla shfrytëzohen për qëllime afariste, personale apo shtëpiake.

48.2 Në një procedurë gjyqësore, të arbitrazhit, falimentimit ose të përmbarrimit të vendimit gjyqësor, asnjë gjykatë ose organ i arbitrazhit nuk është i autorizuar të tentojë për ta kufizuar përgjegjësinë e personit i cili udhëheq me ndërmarrjen individuale. Pa kufizuar përgjithësinë e ndalesës së mësipërme, posaçërisht është e ndaluar që një gjykatë ose organ arbitrazhi të mbrojtë ose të përpiqet të mbrojtë nga kjo përgjegjësi cfarëdo prone apo aset që është në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të këtij personi.

48.3 Si përjashtim i kufizuar i paragrafit 2 të këtij neni, gjykata apo organi i arbitrazhit mund të mbrojnë asetet ose pronën nga kjo përgjegjësi vetëm nëse, dhe vetëm deri në masën, nëse:

(i) kontrata e cila e ka krijuar këtë përgjegjësi shprehimisht e përjashton nga përgjegjësia pronën ose asetet;

(ii) personi ose shoqëria që ka pretendime është pajtuar që këto asetet ose prona të mos i nënshtrohen pretendimeve të tij, ose

(iii) një akt themelor normativ për përmbarrimin e vendimeve gjyqësore ose për falimentim, shprehimisht i lejon gjykatës ose organit të arbitrazhit që të mbrojtë pronën ose asetet e caktuara nga kjo përgjegjësi.

48.4 Prona ose asetet konsiderohen se janë në pronësi të tërthortë (indirekte) të një personi i cili udhëheq me ndërmarrjen individuale nëse:

(i) ky personi ka mundësi që të kontrollojë shfrytëzimin dhe disponimin e këtyrepronave ose aseteve, dhe

(ii) ka dëshmi të mjaftueshme për të konkluduar se një person ose shoqëri tjetër është emëruar formalisht si pronar kryesor me qëllim të mbrojtjes së pronës ose aseteve nga përgjegjësia e personit që menaxhon ndërmarrjen individuale.

48.5 Ndërmarrja individuale nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur, në emrin e saj apo të pronarit.

**LIGJI PËR NDËRMARRJET ("Gazeta Zyrtare e RFJ", nr. 29/96, 33/96 -
korrigj, 29/97, 59/98, 74/99, 9/2001 - Vendimi SUS dhe 36/2002)**

**9.3. Përgjegjësia për detyrimet
Neni 53**

- (1) Ndërmarrja përgjigjet për detyrimet e saj me tërë pasurinë e saj.
(2) Themeluesit, anëtarët dhe aksionarët e ndërmarrjes përgjigjen për detyrimet e ndërmarrjes në rastet dhe në kushtet e përcaktuara me këtë ligj.
(3) Ndërmarrësi përgjigjet për detyrimet e veta me tërë pasurinë e tij.
(4) Disponimet pa kompensim ose me kompensim të parëndësishëm të pasurisë së subjektit të përgjegjës së pakufizuar të përcaktuar me këtë ligj, të bëra në dy vitet e fundit para marrjes së cilësisë së këtij subjekti, mund të kundërshtohen.

**9.4. Iluzioni i personalitetit juridik
Neni 54**

- Themeluesit, anëtarët dhe aksionarët, anëtarët e administratës dhe të bordit ekzekutiv të drejtorëve përgjigjen për detyrimet e ndërmarrjes me tërë pasurinë e vet:
- 1) nëse kanë keqpërdorur ndërmarrjen për të arritur një qëllim që është i ndaluar për ta;
 - 2) nëse e kanë keqpërdorur ndërmarrjen për të dëmtuar kreditorët e tyre;
 - 3) nëse, në kundërshtim me rregullat, e kanë trajtuar pronën e ndërmarrjes sikur të ishte pronë e tyre;
 - 4) nëse kanë pakësuar pasurinë e ndërmarrjes në favor të tyre ose të një personi tjetër, dhe kanë ditur ose është dashur të dinë se ndërmarrja nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj ndaj palëve të treta..

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

89. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
90. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj,"

91. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

**Neni 47
[Kërkesa individuale]**

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj,”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

92. Rreth përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar dhe kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [CA.nr.6119/2019] e 10 shkurtit 2021 të Gjykatës së Apelit, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
93. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Më konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

94. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
95. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”.
96. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

97. Gjykata fillimisht rikujton esencën e rastit dhe që ndërlihet me një Kontratë mbi Ndërtimin, e lidhur ndërmjet “Lesna” në njërin anë si punëkryesë dhe NPB-së në anën tjetër si investitor. “Lesna” si Biznes individual, ishte themeluar në vitin 2000 dhe më tej nga certifikat e regjistrimit të biznesit të NPQ “Lesna”, e cila është në shkresa të lëndës dhe njëkohësisht është e qasshme edhe në uebfaqen e ARBK-së, vërehet se “Lesna” kishte qenë e regjistruar si biznes individual me pronarë Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku. Pas kryerjes së punëve të parapara me kontratë, nga ana e një Komisioni të përbashkët të “Lesna” dhe NPB dhe Raportit të situacioneve rezultoi se, NPB-ja kishte bërë pagesat në vlerë prej 3.152.718,95 euro (tre milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë euro e nëntëdhjetë e pasë cent) në dobi të “Lesna”. Në anën tjetër, nga llogaria përfundimtare rezultoi se vlera e punëve të kryera nga “Lesna” ishte 2.915.384,95 euro (dy milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë e treqind e tetëdhjetë e katër mijë euro e nëntëdhjetë e pasë cent). Në ndërkohë, në vitin 2003 “Lesna” ishte shuar si biznes. NPB-ja kishte paraqitur padi në Gjykatën Ekonomike kundër “Lesna” duke kërkuar kthimin e mjeteve në vlerë prej 318.315,63 euro (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e tre cent). Gjykata Ekonomike e Qarkut kishte miratuar padinë e NPB-së. Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës. Më pas, NPB-ja paraqiti propozim për përmbarim tek Zyra e Përmbarimit Vais Law, në bazë të titullit përmbarimor Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike. Zyra e Përmbarimit kishte lejuar përmbarimin në bazë të titullit përmbarimor, dhe si rrjedhojë “Lesna” kishte paraqitur prapësim në Gjykatën Themelore kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit. Kjo e fundit kishte refuzuar si të pabazuar këtë prapësim. Më pas “Lesna” kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe kjo e fundit refuzoi si të pathemeltë ankesën. “Lesna” kishte paraqitur ankesë tek organi përmbarues dhe tek Ministria e Drejtësisë kundër Zyrës Përmbarimore Vais Law, duke pretenduar parregullësi gjatë procedurës përmbarimore duke pretenduar se është ndryshuar dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, sepse në urdhër përmbarimor janë futur persona që nuk kanë qenë objekt gjykimi në procedurën gjyqësore. Më tutje, si rezultat i propozimit të “Lesna” për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të Ligjshmërisë në Gjykatë Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke theksuar ndër të tjera se përmendja e emrave të pronarëve në aktvendim për lejim të përmbarimit është jorelevante sepse titulli përmbarimor i referohet vetëm detyrimit të “Lesna” e jo edhe të pronarëve të saj.
98. Më tutje, si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Zyra Përmbarimore Vais Law, përmes Urdhrit Përmbarimor, kishte shpallur të përfundur procedurën përmbarimore në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, sepse “Lesna” ishte shuar si biznes dhe se përmbarimi ndaj pronarëve të “Lesna” ishte pamundësuar. NPB-ja kishte ushtruar ankesë në Gjykatën Themelore kundër Urdhrit Përmbarimor, dhe kjo e fundit kishte aprovuar si të bazuar ankesën, dhe për pasojë kishte anuluar Urdhritin përmbarimor duke e kthyer lëndën tek Zyra për Përmbarim. Më tej, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke kërkuar që i njëjti të anulohet dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor me të cilin ishte anuluar procedura përmbarimore. Gjykata e Apelit i aprovoi ankesat dhe çështjen e ktheu në rigjykim. Zyra Përmbarimore Vais Law, kishte bërë kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë që të largohet nga kjo lëndë përmbarimore, dhe kjo e fundit aprovoi kërkesën.
99. Më tutje, lidhur me procedurën të cilën parashtruesit e kërkesës në mënyrë shprehimore e kontestojnë para Gjykatës, ndërlihet me procedurën e dytë të rigjykimit në kuadër të procedurës përmbarimore e cila është paraqitur në mënyrë të detajuar tek përmbledhja e fakteve. Gjykata Themelore duke vepruar në rigjykim aprovoi ankesën e NPB-së dhe e ktheu lëndën tek Përmbaruesi Privat për përmbarim. Parashtruesit e kërkesës sërish paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit dhe kjo e fundit aprovoi ankesën dhe lëndën e ktheu në rigjykim. Gjykata Themelore sërish duke vepruar në rigjykim aprovoi ankesën e NPB-së për eliminimin

e parregullsive të kryera tek Përmbartuesi Privat. Pas ankesës së parashtruesve të kërkesës në Gjykatën e Apelit kjo e fundit refuzoi ankesën si të pabazuar.

100. Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës i kontestojnë këto konstatime të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, të nxjerra në procedurë të dytë të rigjykimit në kuadër të procedurës përmbartimore duke pretenduar fillimisht se me Aktvendimet e lartcekura u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm pretendojnë se: (i) aktvendimet e kontestuara janë përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore; dhe (ii) është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe ai i kontradiktoritetit. Së dyti, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se si rrjedhojë e shkeljes së të drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është shkelur edhe e drejta e tyre në pronë e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
101. Prandaj, Gjykata gjatë adresimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës fillimisht do të trajtojë pretendimin e tyre për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe cenimit të parimit të barazisë së arëve në procedurë dhe atij të kontradiktoritetit duke aplikuar parimet e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, për të vazhduar me vlerësimin e pretendimit të tyre për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
- I. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së
- (i) *Lidhur me pretendimin për zbatim në mënyrë të gabuar të ligjit*
102. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës në kontekst të këtij pretendimi theksojnë se “Lesna” ka qenë e shuar si Biznes që nga viti 2003, dhe sipas tyre procedura kontestimore dhe ajo përmbartimore janë zhvilluar kundër një biznesi i cili nuk ka qenë ekzistent. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu shtojnë se Gjykata e Apelit ka konstatuar se Biznesi Individual NPQ “Lesna” është i shuar. Sipas parashtruesve të kërkesës Rregullorja e UNMIK-ut dhe po ashtu edhe Ligji për Shoqëritë Tregtare me asnjë dispozitë të vetme nuk flasin për borxhet e “biznesit individual” pas shuarjes së tij. Sipas parashtruesve të kërkesës, interpretimi i dispozitave ligjore nuk guxon të tejkalojë përmasat e asaj çka parashihet me ligj.
103. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës shtojnë se Biznesi Individual siç ka qenë “Lesna” nuk mund të ketë më shumë se një pronar, dhe se përgjegjës për borxhet nuk mund të jenë personat që asnjëherë nuk kanë qenë pronar të subjektit të shuar. Më tutje, parashtruesit e kërkesës shtojnë se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të kontestuar ka zbatuar gabimisht nenin 5 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 për Shoqëritë Tregtare, ku si pasojë është cenuar edhe neni 46 i Kushtetutës. Sipas tyre, Gjykata e Apelit këtë dispozitë ligjore është dashur ta interpretojë në kontekst të nenit 5.1, të Rregullores së lartpërmendur i cili sipas tyre ndër të tjera thekson se vetëm personi fizik mund të jetë pronar i biznesit individual e jo personat fizik, sikur në rastin konkret. Sipas parashtruesve edhe pse “Lesna” ka qenë e regjistruar si biznes individual, dhe se përgjatë zhvillimit të procedurës përmbartimore në cilësi të debitorit përfshihen edhe parashtruesit e kërkesës dhe kjo sipas tyre kjo bie ndesh me paragrafin 1 të nenit 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/6.
104. Parashtruesit e kërkesës në fund lidhur me këtë pretendim theksojnë se Gjykata e Apelit bie ndesh me qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme sepse: “Gjykata Supreme në lidhje me këtë çështje juridike në Aktvendimin e saj CML.2/2017 ka mbajtur qëndrimin juridik se “çështja e debitorëve në cilësi të personave fizik as që mund të diskutohet sepse titulli përmbartimor i referohet vetëm NPQ “Lesna.”

105. Gjykata së pari rikujton se këto pretendime specifike parashtuesit e kërkesës i kanë ngritur edhe para gjykatave të rregullta përgjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore.
106. Nga pretendimet e paraqitura në kërkesën e tyre para Gjykatës, Gjykata vëren se parashtuesit e kërkesës, në thelb, pretendojnë interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta.
107. Prandaj, bazuar në shtjellimet e pretendimeve të parashtuesve të kërkesës, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimet për zbatim të gabuar të ligjit hyjnë në sferën e ligjshmërisë apo kushtetutshmërisë.
108. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. KI87/20, parashtues *Suva Rechtsabteilung*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 prillit 2021, paragrafi 57; KIO6/17, parashtues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI75/17, parashtues *X*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 55; dhe KI122/16, parashtues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).
109. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", gjë që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastet e GJEDNJ-së *Balıktaş Bingöllü kundër Turqisë*, Aktgjykim, i 22 qershorit 2021, paragrafi 75; *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim, i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; si dhe rastet e cekura më lart KIO6/17, parashtues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
110. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih, rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Rusisë*, Vendimi për pranueshmëri i 30 qershorit 2005; dhe rastet e Gjykatës të cituara më lart KIO6/17, parashtues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 38; dhe KI122/16, parashtues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57).
111. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në "konkluzione arbitrare" apo "qartazi të paarsyeshme" për parashtuesin (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykim, i 11 janarit 2007 paragrafi 83; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, Aktgjykim, i 23 tetorit 2008 paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, Aktgjykim, i 1 dhjetorit 2005, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa, Aktgjykim, i 25 korrikut 2002, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës cituar më lart KI122/16, parashtues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe KIO5/18, parashtues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

112. Në këtë rast, Gjykata së pari i referohet arsyetimit të dhënë nga Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.297/2016] të 26 prillit 2018, e cila duke vendosur lidhur me prapësimin e parashtruesve lidhur me Urdhërin përmbarimor, kishte konstatuar se në bazë të pargafravë 1 dhe 2 të nenit 48 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, pasuria e pronarit të Biznesit Individual konsiderohet edhe pasuri e Biznesit Individual që është palë debitore.
113. Më tej pasi që Gjykata e Apelit e ktheu në rigjykim Aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore, dhe kjo e fundit sërish aprovoi ankesën e NPB-së, duke anuluar urdhërin [P.nr.174/16] për përfundimin e procedurës përmbarimore dhe lëndën e kthej në Zyrën Përmbarimore, që të vazhdoj më tej me realizimin e përmbarimit. Më tej në arsyetim të vebdimit të lartpërmendur ishte theksuar se *“në Procedurën Përmbarimore nuk është relevante se a është përfshirë pronari i Biznesit Individual si debitor në titullin përmbarimor apo jo, ngase pasuria është unike, e pandarë dhe e tëra është objekt i ekyekutimit, sipas rregullave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore*
114. Lidhur me rastin konkret, Gjykata ka parasysh se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të kontestuar [CA.nr.6119/2019] refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruara nga Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bashkim Deshishku dhe Bekim Deshishku, dhe vërtetoi Aktvendimin [PPP.nr.1255/19] e Gjykatës Themelore, e cila duke vendosur në rigjykim për të dytën herë aprovoi si të bazuar ankesën e NPB-së, lidhur me eliminimin e parregullsive të kryera nga organi përmbarues gjatë procedurës përmbarimore, dhe në këtë mënyrë anuloi Urdhërin [P.nr.174/16] përmes së cilit procedura përmbarimore u konsiderua e përfunduar dhe i cili u nxorr duke u bazuar kryesisht në Aktvendimin [CML.nr.2/2017] e Gjykatës Supreme, të 13 qershorit 2017. Gjykata Themelore përmes Aktvendimin [PPP.nr.1255/19] e kishte kthyer lëndën tek Përmbaruesi Privat për përmbarim sipas propozimit të NPB-së, në cilësi të kreditorit.
115. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr.6119/2019] në adresim të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, ishte thirrur në nenin 5 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së UNMIK 2001, në nenin 48 par. 1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr.06/L-016 i cili ka hy në fuqi më 24 maj 2018 dhe nenit 48 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr.02/L-123 i cili ka hy në fuqi më 01 tetor 2008 si dhe duke pasur parasysh që si datë e regjistrimit të debitorit përmbarimor, është evidentuar: 01 qershori 2000, pastaj me dispozitën e neneve 53 dhe 54 të Ligjit për Ndërmarrjet (Gazeta zyrtare e RSFJ, nr. 29/96, 29/97, 59/98, 74/99) e cila ka vlejte në periudhën kontestuese, dhe lidhur me rastin para nesh Gjykata e Apelit kishte theksuar se ndërmarrja përgjigjet për obligimet e veta me pasurinë e saj të tërësishme, që themeluesit, dhe anëtarët dhe aksionarët e ndërmarrjes përgjigjen për obligimet e ndërmarrjes në rastet dhe nën kushtet e parapara me ligjin e lartpërmendur.
116. Në vijim në arsyetim të Aktvendimit [CA.nr.6119/2019], lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Biznesi Individual nuk mund të ketë më shumë se një pronar, theksohet se *“Në ankesë është cekur se citim; Biznesi individual nuk mund të ketë më tepër se një pronar” duke u thirrë në Ligjin Nr.06/L-016 për Ndërmarrjet Tregtare, megjithatë sipas qëndrimit të Gjykatës së Apelit, nuk është interpretuar drejtë ligji i përmendur për atë se me shikimin në të njëjtin dhe atë në nenin 48 par 1 është konstatuar, citim:” “Një person mund të ketë vetëm një biznes individual”.*
117. Më tej në ndërlidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës, Gjykata e Apelit shton se *“Duke pasur parasysh që si datë e regjistrimit të debitorit përmbarimor, është evidentuar: 01.06.2000, pastaj me dispozitën e neneve 53 dhe 54 të Ligjit për Ndërmarrjet (Gazeta zyrtare e RSFJ, nr. 29/96, 29/97, 59/98, 74/99) e cila ka vlejte në periudhën kontestuese, është paraparë se ndërmarrja përgjigjet për obligimet e veta me sipërfaqen e pasurisë së saj të tërësishme, që themeluesit, anëtarët dhe aksionarët e ndërmarrjes përgjigjen për obligimet e ndërmarrjes në rastet dhe nën kushtet e parapara me këtë Ligj.*

Themeluesit, anëtarët dhe aksionarët, anëtarët e drejtorisë dhe bordit ekzekutiv të drejtorëve përgjigjen për obligimet e ndërmarrjes me pronën e tyre të tërësishme: nëse pasurinë e saj të tërësishme: nëse e kanë keqpërdorur ndërmarrjen që të arrin qëllimin i cili për ta është i ndaluar; nëse e kanë keqpërdorur ndërmarrjen që të dëmtojnë kreditorët e tyre; nëse, kanë vepruar kundër rregullave me pronën e ndërmarrjes si të ishte në pyetje prona e tyre; nëse kanë pasur pronën e ndërmarrjes në shfrytëzim të tyre ose në shfrytëzim të personave tjerë, ndërsa e kanë ditur ose është dashur ta dinë se ndërmarrja nuk do të jete në gjendje të shlyej obligimet e saj ndaj personave të trete.

Duke shqyrtuar aktvendimin e goditur, Gjykata e Apelit gjen se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje esenciale të LPK-se dhe LPP-se në të cilat gjykata ankimore është e detyruar të kujdeset sipas detyrës zyrtare, dhe të njëjtën e ka bazuar në vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në të cilat drejte është aplikuar e drejta materiale. Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke pas parasysh të gjitha nenet e lartcekura të Rregullave ligjore të përmendura, Gjykata e Apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar kur e ka aprovuar si të bazuar. Kundërshtimi i kreditorit përmbarrimor: Ndërmarrja Publiko Banesore AD, me seli në rrugën "Bill Clinton" p.nr, Prishtinë, për eliminimin e parregullsive të cilat organi ekzekutues i ka bërë gjatë procedurës së përmbarrimit, dhe e ka anuluar Urdhrin numër: C.nr.174116 të datës 24.08.2017, për përfundimin e procedurës përmbarrimore sipas konkluzionit korrigjues numër: C.nr.174/16 të datës 19.12.2017, dhe kur e ka kthyer lëndën përmbarrues gjyqësore-përmbarruesit privat, për përmbarrim sipas propozimit të kreditorit përmbarrimor."

118. Nga ajo që u tha më lart, respektivisht sipas interpretimit të gjykatave të rregullta lidhur me rastin konkret rezulton se në procedurën përmbarrimore nuk është relevante se a është përfshirë pronari i Biznesit Individual si debitor në titullin përmbarrimor apo jo, ngase pasuria është unike e pandarë dhe e tëra është objekt i ekzekutimit sipas rregullave të LPP-së. Në rastin konkret pasuria e pronarit konsiderohet edhe pasuri e Biznesit Individual dhe pasuria e Biznesit Individual, konsiderohet pasuri e pronarit, dhe se pronari i biznesit përgjigjet me pasurinë e tij edhe në rast të falimentimit.
119. Në dritën e asaj që u tha më lart rezulton se Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku, si pronarë të Biznesit Individual "Lesna" kanë pasur përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera të shkaktuara nga "Lesna", ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një ndërmarrje individuale. Në arsyetim të vendimit të kontestuar gjithashtu theksohet se "Kjo përgjegjësi është e pakufizuar dhe përfshin tërë pronën dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të këtyre personave në rastin konkret.
120. Prandaj bazuar në atë si më sipër, lidhur me pretendimin e parashtruesve se Rregullorja e UNMIK-ut dhe po ashtu edhe Ligji për Shoqëritë Tregtare me asnjë dispozitë të vetme nuk flasin për borxhet e "biznesit individual" pas shuarjes së tij si dhe pretendimeve të parashtruesve se një biznes individual nuk mund të ketë më shumë se një pronar, Gjykata konsideron se interpretimi i dispozitave të lartcekura ligjore dhe arsytimit të dhënë nga gjykatat e rregullta, në veçanti atij të Gjykatës së Apelit nuk ka rezultuar me konkluzione arbitrare dhe qartazi të paarsyeshme për asrjes se këto të fundit kanë ofruar një arsyetim të detajuar në lidhje me interpretimin e dispozitave relevante në fuqi që ndërlidhen me procedurën e zhvilluar në rastin konkret.
121. Gjykata ripërsëritë se Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës të cituar më lart, KI75/17, parashtrues X, paragrafi 59)
122. Prandaj, Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesës, përtej pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i aplikimit të gabuar të ligjit, nuk mbështesin mjaftueshëm dhe as

nuk argumentojnë para Gjykatës, se si ky interpretim i “*ligjshmërisë*” nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore, mund të ketë qenë jo i drejtë.

123. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre nuk kanë arritur të dëshmojnë dhe të mbështesin pretendimin e tyre se si Gjykata Apelit gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale ka shkelur të drejtën e tyre të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

ii) *Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit*

124. Në ndërlidhje me këtë pretendim, Gjykata së pari rikujton thelbin e pretendimit të parashtruesve të kërkesës, i cili ndërlidhet me atë se në procedurën kontestimore të zhvilluar lidhur me këtë rast, në të cilën është vërtetuar borxhi, si palë ndërgjygjëse kanë qenë NPB-ja dhe “Lesna” por jo edhe parashtruesit e kërkesës Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku. Sipas tyre si rezultat i mosmarrjes pjesë në procedurën gjyqësore ata “*nuk kanë pasur mundësi të paraqesin përgjigjet, provat dhe argumentet e tyre në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre*”.
125. Parashtruesit e kërkesës për të mbështetur pretendimet e tyre, i referohen disa rasteve të Gjykatës, respektivisht rasteve: KI200/13, parashtrues *Belkize Kallaq*; KI108/10, parashtrues *Fadil Selmanaj*; KI209/19 parashtrues *Memli Krasniqi*, duke shtuar se “*palët në procedurë, përveç që duhet të jenë të evidentuara si palë në parashtrësat e dorëzuara në Gjykatë, të njëjtave duhet që pashmangshmërisht të iu ofrohet mundësia e paraqitjes së përgjigjeve, argumenteve dhe provave të tyre*”. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se atyre nuk iu është dhënë mundësia të jenë palë dhe të paraqesin argumentet e tyre gjatë procedurës kontestimore.
126. Rrjedhimisht, në dritën e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata do t’i shtjellojë parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve.

Parimet e përgjithshme sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së përkitazi me parimin e kontradiktoritetit dhe atë të barazisë së armëve

127. Gjykata fillimisht sqaron se parimi i “*barazisë së armëve*” është element i një koncepti më të gjerë të një gjykimi të drejtë që kërkon “*ekuilibër të drejtë midis palëve*” ku secilës palë i jepet mundësi e arsyeshme të paraqes rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare. (shih rastin e GJEDNJ *Yvon kundër Francës*, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31, dhe rastin e GJEDNJ *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, paragrafi 33; shih, *mutatis mutandis*, po ashtu rastin e Gjykatës KI31/17, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktgjykim i 30 majit 2017, paragrafi 70).
128. Parimi i kontradiktoritetit procedural në anën tjetër, nënkupton që palët në procedurë duhet të kenë dijeni dhe mundësi të komentojnë dhe kundërshtojnë pretendimet dhe provat që paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Brandstetter kundër Austrisë*, nr. 11170/84, Aktgjykimi i 29 gushtit 1991; *Vermeulen kundër Belgjikës*, nr. 19075/91, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1996; shih rastin e Gjykatës, KI193/19, parashtrues *Salih Mekaj*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 47).
129. Duke u referuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata potencon se parimi i barazisë së armëve dhe parimi i kontradiktoritetit procedural janë të lidhur ngushtë dhe në shumë raste GJEDNJ i ka trajtuar së bashku (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Rowe and Dawis*

kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 18990/91; Aktgjykimi i vitit 2000, *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27052/95, Aktgjykimi i vitit 2000; *Zahirović kundër Kroacisë*, nr. 58590/, Aktgjykimi i 25 korrikut 2013; shih rastin e Gjykatës, KI193/19, parashtrues *Salih Mekaj*, cituar më lart, paragrafi 48).

130. Kërkesa e "barazisë së armëve", në kuptimin e një "ekuilibri të drejtë" midis palëve, vlen në parim për raste civile si dhe për raste penale (shih rastin e Gjykatës KI10/14, parashtrues, *Shoqëria aksionare Raiffeisen Bank Kosove SH. A.*, Aktgjykim i 20 majit 2014, paragrafi 42; dhe rastin e Gjykatës KI31/17, parashtrues *Shefqet Berisha* cituar më lart, paragrafi 71).
131. GJEDNJ ka theksuar se sipas parimit të "barazisë së armëve", është e papranueshme që një palë në procedurë të paraqesë vërejtje apo komente para gjykatave të rregullta, të cilat kanë për qëllim që të ndikojnë në vendimmarrjen e gjykatës, pa dijeninë e palës tjetër dhe pa i dhënë mundësi palës tjetër të përgjigjet në to. I takon palës së përfshirë në procedurë pastaj të vlerësojë nëse vërejtjet apo komentet e paraqitura nga pala tjetër meritojnë reagim (shih rastin e GJEDNJ, *APEH Üldözötteinek Szövetsége and others kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 5 janarit 2011, paragrafi 42; shih gjithashtu, rastin e GJEDNJ *Guigue and SGEN-CFDT kundër Francës*, Vendim i 13 korrikut 2000).
132. Andaj, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, parimi i "barazisë së armëve" cenohet kur ankesa e palës kundërshtare nuk i është komunikuar parashtruesit të kërkesës dhe ai nuk është informuar për një ankesë të tillë përmes ndonjë mënyre tjetër (shih rastin e GJEDNJ *Beer kundër Austrisë*, Aktgjykim i 6 shkurtit 2001, paragrafi 19; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ *Andersena kundër Letonisë*, Aktgjykim i 19 shtatorit 2019, paragrafi 87). Ngjashëm, GJEDNJ kishte konstatuar shkelje të këtij parimi në rast kur vetëm një nga dy dëshmitarët kyç është lejuar që të dëshmojë (shih rastin *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, cituar më lartë, paragrafi 34 dhe 35).
133. GJEDNJ po ashtu kishte konstatuar shkelje të parimit të "barazisë së armëve" për shkak të pozicionit të prokurorit të përgjithshëm në procedurën para Gjykatës së Auditimit, që për dallim nga palët në procedurë, prokurori i përgjithshëm ishte i pranishëm në seancë, ishte i informuar paraprakisht për pikëpamjen e gjyqtarit raportues, merrte pjesë plotësisht në debate dhe kishte mundësinë të shprehte me gojë pikëpamjen e tij pa u kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse, dhe kjo mungesë ekuilibri theksohej nga fakti se seanca nuk ishte publike. Kjo për GJEDNJ-në kishte ngritur çështjen e mos-balancës në mes të palëve në procedurë (shih rastin e GJEDNJ *Martinie kundës Francës*, Aktgjykim i 12 prillit 2006, paragrafi 50).
134. GJEDNJ kishte gjetur shkelje të parimit të "barazisë së armëve" edhe në rastin *Yvon kundër Francës* kur komisionari i Qeverisë, merrte pjesë në procedurë gjyqësore për përcaktimin e shumës së shpronësimit, së bashku me autoritetin e shpronësimit kundër palës tjetër prona e të cilit ishte subjekt shpronësimi. GJEDNJ kishte konstatuar në këtë rast se pala e shpronësuar ishte ballafaquar jo vetëm me autoritetin e shpronësimit por edhe me komisionarin e Qeverisë, ku këta të fundit kanë pasur përparësi të dukshme për qasje në dokumente në raport me palën e shpronësuar. Për më tepër, komisionari i Qeverisë, që ishte edhe ekspert edhe palë në procedurë, kishte qenë në pozicion dominues dhe kishte mundësi për të ushtruar një ndikim të madh në vlerësimin e gjyqtarit. Kjo për GJEDNJ-në kishte ngritur çështjen e mos-balancës *vis a vis* palës së shpronësuar që ishte e papajtueshme me parimin e "barazisë së armëve" (shih rastin e GJEDNJ *Yvon kundër Francës*, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 37).
135. Megjithatë, GJEDNJ ka theksuar se e drejta e palëve lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë duke përfshirë edhe parimin e "barazisë së armëve" nuk është absolute. Shtetet gëzojnë një margjinë të caktuar të vlerësimit në këtë aspekt. Por, i takon GJEDNJ-së që të vendos në instancë të fundit nëse këto parime respektohen (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ *Regner kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 19 shtatorit 2017, paragrafi 147).

Zbatimi i këtyre parimeve në rastin e parashtruesve të kërkesës

136. Lidhur me shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit, esenca e pretendimit të parashtruesve të kërkesës ndërlidhet me faktin se në procedurën kontestimore të zhvilluar lidhur me këtë rast, në të cilën është vërtetuar borxhi, si palë ndërgjygjëse kanë qenë NPB-ja dhe “Lesna” ndërsa Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku si pronarë të “Lesna” nuk kanë marrë pjesë në procedurën gjyqësore dhe në këtë mënyrë këta të fundit pretendojnë se nuk kanë pasur mundësi të paraqesin përgjigjet, provat dhe argumentet e tyre në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre.
137. Si rezultat i faktit se nuk kanë marrë pjesë në procedurën kontestimore, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk mund të jenë subjekt i procedurës përmbarimore.
138. Gjykata së pari thekson se në procedurën kontestimore të zhvilluar për vërtetimin e borxhit, si palë ndërgjygjëse kanë qenë NPB në cilësi të kreditorit dhe në anën tjetër NPQ “Lesna” si biznes individual e cila në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, konsiderohet si person fizik, në cilësi të debitorit.
139. Më tutje nga certifikat e regjistrimit të biznesit të NPQ “Lesna”, e cila është në shkresë të lëndës dhe njëkohësisht është e qasshme edhe në uebfaqen e ARBK-së, vërehet se “Lesna” kishte qenë e regjistruar si biznes individual me pronarë Hashim Deshishku, Rizah Deshishku, Bekim Deshishku dhe Bashkim Deshishku.
140. Gjithashtu nga shkresat e lëndës vërehet se “Lesna” ishte shuar si biznes në vitin 2003.
141. Më tej Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se në procedurën kontestimore lidhur me vërtetimin e borxhit, respektivisht përgjatë procedurës së zhvilluar para gjykatave, si palë ndërgjygjëse ishin NPB dhe “Lesna”, dhe më tej rezulton se kjo e fundit ishte e përfaqësuar nga përfaqësuesja ligjore K.K, përmes parashtrimit të ankesave dhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor.
142. Nga si më sipër, Gjykata vëren se fakti se “Lesna” e cila kishte qenë e regjistruar si biznes individual, respektivisht edhe sipas legjislacionit përkatës të lartpërmendur që rregullon këtë fushë, biznesi individual nënkupton vet pronarin. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës kanë pasur mundësi të paraqesin përgjigjet, provat dhe argumentet e tyre në mënyrë që të mbrojnë interesat e tyre.
143. Në këtë drejtim dhe në adresim të këtij pretendimi, Gjykat i referohet Aktvendimit [PPP.nr.1255/19] të 9 shtatorit 2019, të Gjyktës Themelore, i cili ishte nxjerrë në procedurën e parë të rigjyimit në kuadër të procedurës përmbarimore, dhe ku ndër të tjera në arsyetim theksohej se duke u bazuar në nenin 48 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, gjatë procedurës përmbarimore nuk është e rëndësishme nëse pronari i një ndërmarrje individuale është i përfshirë si debitor ose jo në titull ekzekutiv, sepse prona është unike e pandashme dhe si tërësi i nënshtrohet përmbarimit.
144. Dhe duke iu referuar rastit konkret, Gjykata Themelore në Aktvendimin e lartpërmendur duke i renditur përjashtimet që janë të parapara me nenin 48 par. 3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare theksohet se: *“Gjykata apo organi i arbitrazhit mund të mbrojnë asetet ose pronën nga kjo përgjegjësi vetëm nëse, dhe vetëm deri në masën e nëse*
(i) kontrata e cila e ka krijuar këtë përgjegjësi shprehimisht e përjashton nga përgjegjësia pronën ose asetet;
(ii) personi ose shoqëria që ka pretendime është pajtuar që këto asetet ose prona të mos i nënshtrohen pretendimeve të tij, ose

(iii)një akt themelor normativ për përmbarimin e vendimeve gjyqësore ose për falimentim, shprehimisht i lejon gjykatës ose organit të arbitrazhit që të mbrojë pronën ose asetet e caktuara nga kjo përgjegjësi”.

145. Në rastin konkret, Gjykata Themelore konsideroi se nuk është arritur asnjëra nga këto përjashtime për ta mbrojtur pasurinë ose pronën e parashtruesve të kërkesës nga përgjegjësia.
146. Më tutje, Gjykata e Apelit me Aktvendimin [CA.nr.6119/19], të cilin parashtruesit e kërkesës e kontestojnë para Gjykatës, e mbështeti në tërësi Aktvendimin e lartcekur duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruesve të kërkesës.
147. Në dritën e parimeve të përgjithshme të GJEDNJ-së, të elaboruara më lartë dhe arsyetimin e gjykatave të rregullta, Gjykata fillimisht vëren se në rastin e parashtruesve të kërkesës gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje me standardet e kërkuara për gjykim të drejtë.
148. Gjykata po ashtu vëren, se procedura para gjykatave të rregullta e zhvilluar në rastin e parashtruesve të kërkesës kishte qenë e rregullt në tërësinë e saj. Prandaj, bazuar në arsyetimin si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë arritur të dëshmojnë se në rastin e tyre gjykatat e rregullta kanë shkelur parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në pajtim me parimet e vendosura përmes praktikës së GJEDNJ-së, të cilat janë të mishëruara edhe në dispozitat përkatëse ligjore.

Pretendimi për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës

149. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “[...] në procedurën e përmbarimit, zotërinjëve, Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku , u është cenuar prona në mënyrë arbitrare, fillimisht nga ana e Përmbaruesit Privat, e më pas edhe nga ana e gjykatave të rregullta të vendit tonë, të cilët ishin të vetëdijshëm se Parashtruesit nuk ishin të evidentuar në dokumentin përmbarimor, kishin lejuar përmbarimin edhe në pjesët e pasurisë private të tyre, duke i caktuar si Debitor” dhe në këtë mënyrë u është shkelur e drejta në pronë e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
150. Në këtë kontekst, Gjykata vë në pah se parashtruesit e kërkesës pretendimin e tyre për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në mënyrë specifike e ndërlidhin me pretendimin e tyre për shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i pretendimit të tyre për shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat në mënyrë specifike i referohen pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit dhe shkeljes së parimit të barazisë së armëve dhe atij të kontradiktoritetit ka konstatuar se këto të fundit janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
151. Prandaj dhe si më sipër Gjykata konstaton se parashtruesve të kërkesës, respektivisht nuk i është cenuar prona në mënyrë arbitrare, por procedura e përmbarimit edhe në pjesët e pasurisë private të tyre, ishte realizuar bazuar në procedurën përmbarimore të zhvilluar lidhur me rastin konkret.
152. Gjykata konsideron se edhe pretendimi i parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës së tyre në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, dhe rrjedhimisht i papranueshëm ashtu siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

153. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata më sa vijon: *"Cenimi arbitrar i pasurisë së Parashtruesve (Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku), krijon një precedent të rrezikshëm dhe cenon rëndë sigurinë juridike të subjekteve të së drejtës sepse procedura gjyqësore pranë gjykatave të rregullta ka instaluar përgjegjësi për të tjerët në kundërshtim me çdo dispozitë ligjore në fuqi. Kjo për faktin se, procedura përmbartimore është iniciuar dhe përfunduar edhe ndaj Parashtruesve (Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku) me anë të një dokumenti përmbartimor, i cili është nxjerr në procedurën kontestimore, procedurë e cila shërben si procedurë e faktit (siç është sqaruar në Kërkese, pa pjesëmarrjen si palë të Parashtruesve), i cili ka shërbyer si bazë për të marrë pasurinë e (Hashim, Rizah, Bekim dhe Bashkim Deshishku), në procedurë të përmbartimit apo siç njihet në procedurën e ekzekutimit. Rrjedhimisht, rezultati i arritur në procedurë të faktit nuk ka pasur as për se afërmi qëllimin i cili është realizuar në procedurë të ekzekutimit".* Përveç kërkesës për masë të përkohshme, parashtruesit e kërkesës gjithashtu paraqitën edhe një shkresë tjetër në Gjykatë, në bazë të së cilës kërkuar, që Gjykata të vendos lidhur me kërkesën e tyre në një afat sa më të shpejtë kohor.
154. Megjithatë, Gjykata sapo konkludoi që kërkesa e parashtruesve të kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme në baza kushtetuese.
155. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet, pasi e njëjta nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit pasi kërkesa u shpall e papranueshme.

Kërkesa për seancë dëgjimore

156. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkuar nga Gjykata të caktojë seancë dëgjimore *"që për shkak të natyrës së komplikuar procedurale të rastit dhe me qëllim që ta kuptojmë tërësisht thelbin e çështjes të caktoj mbajtjen e seancës dëgjimore"*.
157. Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit (2), të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dore] të Rregullores së punës, Gjykata urdhëron mbajtjen e seancës dëgjimore vetëm *"në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit"*.
158. Gjykata përsëritë konstatimin se kërkesa e parashtruesve të kërkesës u deklarua e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese. Në këtë aspekt dhe duke qenë se nuk ka asnjë çështje të provave apo të ligjit që duhet qartësuar, Gjykata e refuzon kërkesën për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 27, 48 të Ligjit dhe rregullave 39 (2) dhe 57 të Rregullores së punës, më 26 maj 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. TË REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;
- IV. TUA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- V. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani